



Mbroni pajisjet tuaja nga viruset dhe malware


Si mund të infektohen pajisjet e mia?

Një produkt antivirus është një program i krijuar për të zbuluar dhe eliminuar viruset dhe llojet e tjera të programeve keqdashëse nga kompjuteri ose laptopi juaj.

Softueri keqdashës - i njohur si malware - është kod që mund të dëmtojë kompjuterët dhe laptopët tuaj, si dhe të dhënat që gjenden në to. Pajisjet tuaja mund të infektohen nëse shkarkoni aksidentalisht malware nga një bashkëngjitje në një email të dyshimtë, duke vizituar një faqe interneti të infektuar ose duke përdorur një USB të infektuar.

Pasi të jetë në kompjuterin ose laptopin tuaj, malware mund t'ju vjedhë të dhënat, t'i kodojë në mënyrë që të mos mund t'i aksesoni ose madje t'i fshijë plotësisht.

Pra, është vërtet e rëndësishme që të përdorni gjithmonë softuer antivirus dhe ta mbani atë të përditësuar, për të mbrojtur të dhënat dhe pajisjet tuaja.



Cilin antivirus duhet të përdor?



Antivirusi shpesh përfshihet falas me kompjuterët Windows dhe Apple. Nëse ndizni këtë antivirus të integruar, do të jeni menjëherë më të sigurt.

Ju gjithashtu mund të blini një produkt të veçantë antivirus të cilët vijnë me një provë falas, por kini parasysh se:

- › kur skadon versioni i provës, do të duhet të paguani (ose të regjistroheni) për të vazhduar përdorimin e tij
- › produkte të veçanta antivirus nuk do të funksionojnë gjithmonë së bashku me softuerin e integruar antivirus dhe madje mund ta ndalojnë atë të funksionojë plotësisht

A kam nevojë për antivirus në telefonin dhe tabletin tim?



Jo - por sigurohuni që të instaloni vetëm aplikacione dhe softuerë nga dyqanet zyrtare si Google Play dhe Apple App Store që janë kontrolluar për të siguruar mbrojtje nga malware. Ju gjithashtu duhet të vendosni aplikacionet tuaja (dhe vetë tabletin/telefonin) që të përditësohen automatikisht.

Si ta përdor antivirusin tim?



- › Kur instaloni për herë të parë antivirusin tuaj, kryeni një skanim të plotë për t'u siguruar që kompjuteri juaj të mos ketë programe të cilat njihen si keqdashëse.
- › Sigurohuni që programi juaj antivirus të jetë i vendosur që të skanojë automatikisht të gjithë skedarët e rinj, çdo gjë që shkarkoni në internet ose transferoni nga një USB, një hard disk i jashtëm ose kartë SD.
- › Sigurohuni që programi juaj antivirus të jetë i caktuar për të marrë përditësime automatikisht.



Mbani të përditësuar të gjitha pajisjet tuaja

Përditësoni të gjitha aplikacionet dhe pajisjen tuaj kur ju kërkohet. Ju gjithashtu duhet:

- › vendosni softuerët dhe pajisjet të përditësohen automatikisht, duke përfshirë softuerin tuaj AV(antivirus).
- › zëvendësoni pajisjet e vjetra (që nuk gjenden më në shitje) me modele më të reja - kërkoni në internet për të parë se sa kohë suportohet zyrtarisht pajisja juaj aktuale